



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 160

Tiranë – E Premte, 17 Tetor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 119/2014 datë 18.9.2014	Për të drejtën e informimit 8161
Ligj nr. 120/2014 datë 18.9.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar 8169
Ligj nr. 122/2014 datë 25.9.2014	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 17.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014”” 8170
Ligj nr. 123/2014 datë 25.9.2014	Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë..... 8171
Ligj nr. 124/2014 datë 25.9.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9718, datë 19.4.2007, “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 8175
Ligj nr. 125/2014 datë 25.9.2014	Për një shtesë në ligjin nr. 17/2014, datë 20.2.2014, “Për një shtesë në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar” 8177
Dekret nr. 8730 datë 3.10.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8177
Dekret nr. 8737 datë 13.10.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8178
Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 35, datë 30.9.2014	Për procedurat e lëvizjes paralele, të emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar..... 8178
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4879/3, datë 10.10.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Përdorura në qytetin e Korçës”..... 8184
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të vdekur të shtetasit Bardhul Musaj 8185
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të vdekur të shtetasit Roland Gjyli 8185



LIGJ
Nr. 119/2014

PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.

2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë.

3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet publik”:

a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj;

b) janë shoqëritë tregtare ku:

i) shteti zotëron shumicën e aksioneve;

ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike;

c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e

drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

2. “Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.

3. “Person” është çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, si dhe personat pa shtetësi.

4. “Të dhëna personale” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndryshuar.

5. “Programe transparence” është tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik, sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 7 të këtij ligji.

6. “Koordinator për të drejtën e informimit” është nëpunësi civil i përcaktuar në nenin 10 të këtij ligji.

KREU II

**E DREJTA E INFORMIMIT DHE
TRANSPARENCA**

Neni 3

E drejta e informimit

1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.

2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.

3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.

4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

Neni 4

**Përgatitja dhe miratimi i programeve të
transparencës**

1. Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.



2. Në përgatitjen e projektprogramit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;

b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;

c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Neni 5

Rishikimi i programit të transparencës

1. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

2. Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por, në asnjë rast, nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet.

Neni 6

Programet model të transparencës

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 7

Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë

1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit:

a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

b) tekstet e plota:

i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

ii) të ligjeve;

Faqe | 8162

iii) të akteve nënligjore;

iv) të kodeve të sjelljes;

v) të çdo dokumenti politikash;

vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;

c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:

i) listën e kontratave të lidhura;

ii) shumën e kontraktuar;

iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;



iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;

j) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

2. Autoriteti publik, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

3. Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike.

Neni 8

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

1. Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e

dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.

2. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit.

Neni 9

Informacioni i dhënë më parë

1. Autoriteti publik bën të mundur që informacioni, i cili i është dhënë të paktën një herë një kërkuesi, të bëhet i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë personat e tjerë që mund ta kërkojnë në të ardhmen.

2. Kërkesat për informim për informacione të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve plotësohen jo më vonë se 3 ditë pune nga momenti i paraqitjes së kërkesës.

Neni 10

Kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit

1. Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit.

2. Koordinatori për të drejtën e informimit ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;

b) krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji;

c) bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj;

ç) regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre;

d) dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se



autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar;

dh) verifikon rastet për dhënie falas të informacionit qytetarëve, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 13, të këtij ligji;

e) kryen njoftimet paraprake, sipas neneve 14 dhe 15, të këtij ligji, si dhe komunikon me kërkuuesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

KREU III

NJOHJA ME INFORMACIONIN PUBLIK

Neni 11

Kërkesa për informim

1. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.

2. Në çdo rast, kërkesa për informim regjistrohet dhe për të caktohet një numër rendor. Numri rendor, së bashku me të dhënat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepet kërkuarit që ka bërë kërkesën për informim.

3. Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre.

4. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;
- ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;
- d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

5. Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

Neni 12

Saktësimi dhe trajtimi i kërkesës për informim

1. Në rastet kur autoriteti publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim, është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, ai kontakton menjëherë, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës, me kërkuuesin për të bërë sqarimet e nevojshme. Në çdo rast, autoriteti publik ndihmon kërkuuesin në saktësimin e kërkesës.

2. Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendrike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.

3. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuuesin se kërkesa e tij është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.

Neni 13

Kostoja e shërbimit

1. Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë. Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, e dërgimit të tij. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas.

2. Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni. Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg.

3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shqyrtton periodikisht, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, tarifën e bërë publike nga autoritetet publike dhe, sipas rastit, urdhëron ndryshimin e tyre.



4. Qytetarët e regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar, e përfitojnë informacionin falas deri në një numër të caktuar faqesh për çdo kërkesë ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër.

5. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave me udhëzim të përbashkët përcaktojnë numrin e faqeve, për të cilat informacioni përfitohet falas, sipas pikës 4, të këtij neni, si dhe rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifës.

Neni 14

Mënyrat e dhënies së informacionit

1. Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

2. Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit:

a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta;

b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.

3. Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

4. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar.

Neni 15

Afati për marrjen e informacionit

1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.

2. Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë.

3. Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme:

a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;

b) nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;

c) nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuarit.

4. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.

5. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji.

Neni 16

Njoftime paraprake për kërkuarin

1. Në qoftë se autoriteti konstaton se trajtimi i një kërkesë për informim ka kosto të lartë ose se trajtimi i saj kërkon më shumë kohë se afati i parashikuar në pikën 1, të neni 14, të këtij ligji, autoriteti publik njofton menjëherë për këtë kërkuarin dhe i propozon mundësinë e ndryshimit të kërkesës së tij.

2. Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuarit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni. Kur informacioni nuk kërkohet në format elektronik, autoriteti publik nuk mund t'i përgjigjet kërkesës, duke i treguar kërkuarit adresën e saktë të faqes ku informacioni gjendet në formë elektronike.

3. Pas marrjes së kërkesës për informim, autoriteti publik llogarit shumën që duhet paguar për riprodhimin dhe, sipas rastit, për dërgimin e informacionit dhe njofton menjëherë kërkuarin. Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.



KREU IV KUFIZIMI I SË DREJTËS PËR INFORMIM

Neni 17 Kufizime

1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:

- a) të drejtën për një jetë private;
- b) sekretin tregtar;
- c) të drejtën e autorit;
- ç) patentat.

Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:

- a) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;
- b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;
- c) mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;
- ç) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;
- d) formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit;
- dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor;
- e) këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike;
- ë) mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërko-mbëtare ose ndërqeveritare.

Pavarësisht nga sa parashikohet në paragrafin e parë, të pikës 2, të këtij neni, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

Kufizimi mbi të drejtën e informimit, për shkak të interesit të parashikuar në pikën 2, shkronjat “c” dhe “ç”, të këtij neni, nuk zbatohet kur hetimi administrativ, në kuadër të një procedimi disiplinor, dhe procedurat e inspektimit e të auditimit të autoriteteve publike kanë përfunduar.

Kufizimi mbi të drejtën e informimit, për shkak të interesit të parashikuar në pikën 2, shkronjat “d” dhe “dh”, të këtij neni, nuk zbatohet kur të dhënat përkatëse janë fakte, analiza të fakteve, të dhëna teknike ose të dhëna statistikore.

Kufizimi mbi të drejtën e informimit, për shkak të interesit të parashikuar në pikën 2, shkronja “e”, të këtij neni, nuk zbatohet pasi politikat janë bërë publike.

3. E drejta e informimit kufizohet, nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe në qoftë se përhapja e informacionit do të shkelte sekretin profesional të garantuar nga ligji.

4. E drejta e informimit kufizohet edhe kur, pavarësisht nga ndihma e dhënë nga autoriteti publik, kërkesa mbetet e paqartë dhe bëhet i pamundur identifikimi i informacionit të kërkuar.

5. E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar. Autoriteti publik njofton menjëherë kërkuesin për fillimin e procedurës për rishikimin e klasifikimit, sipas ligjit, dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve pune. Në çdo rast, vendimi për trajtimin ose jo të kërkesës për informim merret dhe arsyetohet në bazë të kriterëve të këtij neni.

6. Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim.

7. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji, pavarësisht nga parashikimet e ligjit për arkivat.



KREU V
SHKELJET DHE SANKSIONET
ADMINISTRATIVE

Neni 18

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

1. Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë veprë penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;

b) mosvënia në zbatim e programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;

c) mosrishikimi i programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 5, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;

ç) mosndjekja e procedurave për rishikimin e programit institucional të transparencës, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;

d) moskrijimi, mosmbajtja, mospublikimi apo mospërditësimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;

dh) mosplotësimi i kërkesave për informacione, të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, brenda afatit dhe sipas mënyrës së parashikuar në nenin 9, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;

e) mosregjistrimi i kërkesës për informim, mosçaktimi i një numri rendor për të dhe mosdhënia e të dhënave të kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;

ë) mosdërgimi i kërkesës për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afatit të parashikuar në pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;

f) dërgimi i kërkesës për informim tek një autoritet tjetër publik kur autoriteti që ka marrë

kërkesën e ka informacionin e kërkuar, në kundërshtim me kërkesën e pikës 2, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;

g) mosnjoftimi i kërkesit se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër dhe kontaktet e nevojshme i janë dërguar autoritetit tjetër, në kundërshtim me parashikimet e pikës 3, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;

gj) mospërcaktimi paraprakisht i një tarife, mospublikimi, ose çaktimi i tarifave abuzive për riprodhimin dhe dërgimin e informacionit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 13, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;

h) mosrespektimi i kërkesave të pikës 4, të nenit 13, të këtij ligji, për dhënien falas të informacionit, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;

i) refuzimi i paarsyetuar i preferencës së kërkesit për mënyrën e dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e pikës 4, të nenit 14, të këtij ligji, dënohet me 25 000 deri në 50 000 lekë;

j) mosnjoftimi i kërkesit për vendimin për zgjatjen e afatit për plotësimin e kërkesës për informim, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 15, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;

k) moskryerja e njoftimeve paraprake, sipas parashikimeve të nenit 16, të këtij ligji, dënohet me 25 000 deri në 50 000 lekë;

l) dëmtimi ose shkatërrimi i dokumenteve zyrtare, me qëllim shmangien e së drejtës për informim, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;

ll) moszbardhja e dokumenteve zyrtare, në kundërshtim me rregullat në fuqi, me qëllim pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë.

3. Procedurat e konstatimit, shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative janë ato të parashikuara në ligjin për kundërvajtjet administrative.

Neni 19

Përgjegjësia administrative

1. Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore - administrative për shkeljet administrative



të parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “h”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji.

2. Në përputhje me parashikimet përkatëse të legjislacionit në fuqi që rregullon procedurën administrative, titullari i autoritetit publik e delegon kompetencën e tij për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në pikën 1, të nenit 4, pikat 1 dhe 2, të nenit 5, pikat 1 dhe 2, të nenit 13, te nëpunësi më i lartë civil i autoritetit publik, sipas klasifikimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”. Në këtë rast, nëpunësi më i lartë civil mban përgjegjësi ligjore për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “g”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji.

3. Koordinatorin për të drejtën e informimit ka përgjegjësi administrative, sipas parashikimeve të këtij ligji, për kundërvajtjet administrative të parashikuara në shkronjat “a”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j” dhe “k”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji.

4. Çdo nëpunës i autoritetit publik ka përgjegjësi administrative për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat “l” dhe “ll”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji.

Neni 20

Marrëdhëniet me Kuvendin

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale raporton në Kuvend ose në komisionet parlamentare të paktën një herë në vit ose sa herë që kërkohet prej tyre. Gjithashtu, ai mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që i çmon të rëndësishme. Raporti përmban të dhëna dhe shpjegime për zbatimin e së drejtës për informim në Republikën e Shqipërisë, si dhe programet e transparencës.

2. Nuk lejohet njoftimi për çështje konkrete, me përjashtim të çështjeve të kërkuara me vendim të Kuvendit.

3. Gjatë përpilimit të raportit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbledh të dhëna nga autoritetet publike dhe nga organizatat jofitimprurëse që kanë për mision mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, duke evidentuar komunikimet përkatëse.

Neni 21

Mënyra e shlyerjes së masës së dënimit me gjobë

1. Masa e dënimit, e përcaktuar me gjobë, shlyhet me këste mujore.

2. Këstet mujore caktohen në një masë të tillë që nëpunësit dhe familjes së tij t'i garantohet jetesa, të paktën në nivelin e pagës minimale, të caktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave.

3. Për shkelje të parashikuara në shkronjat “l” dhe “ll”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mund të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Neni 22

Ankimi i sanksioneve administrative

Personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, mund të bëjë ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 23

Arkëtimi i shumave të detyrimeve

1. Vendimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vendosjen e gjobës i komunikohet titullarit të autoritetit publik dhe zyrës së financës.

2. Gjjobat ekzekutohen nga zyra e financës së autoritetit publik, për të cilin punon kundërvajtësi, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të tyre. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përbarimit me kërkesë të komisionerit.

3. Gjjobat arkëtohen në Buxhetin e Shtetit.

KREU VI

KOMPETENCAT DHE PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 24

Procedurat për shqyrtimin e ankesave

1. Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe



Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

2. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:

a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;

b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

3. Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t'u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

4. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi.

5. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos:

a) mospranimin e ankesës kur:

i) ka kaluar afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni;

ii) ankimi nuk paraqitet në formë shkresore;

iii) nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit;

b) pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme;

c) rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht;

ç) afatin, brenda të cilit autoriteti publik duhet të zbatojë urdhrin.

6. Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës.

7. Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk cenon kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit".

Neni 25

Ankimi në gjykatë

Kërkuesi ose autoriteti publik ka të drejtë ta ankimojë vendimin e komisionerit në gjykatën administrative kompetente.

Neni 26

Shpërblimi i dëmit

Çdo person, që ka pësuar një dëm, për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar, në përputhje me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë".

Neni 27

Shfuqizime

Ligji nr. 8503, datë 30.6.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", shfuqizohet.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.9.2014

KRYETARI

Ilir Meta

LIGJ

Nr. 120/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9887, DATË 10.3.2008, "PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimi "Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" zëvendësohet me emërtimin "Komisioneri për të Drejtën e



Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Neni 2

Në nenin 3, pas pikës 27 shtohen pikat 28 dhe 29 me këtë përmbajtje:

“28. “E drejtë informimi” ka kuptimin sipas përcaktimit në ligjin për të drejtën e informimit.

29. “Programe të transparencës” ka kuptimin sipas përcaktimit në ligjin për të drejtën e informimit.”.

Neni 3

Në nenin 29, pika 1, në rreshtin e dytë, pas fjalës “personale” shtohen fjalët “dhe të drejtën e informimit”.

Neni 4

Në nenin 30, titulli ndryshohet si më poshtë:

“Të drejtat në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale”.

Neni 5

Në nenin 31, titulli ndryshohet si më poshtë:

“Kompetencat në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale”.

Neni 6

Pas nenit 31 shtohet neni 31/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 31/1

Kompetencat në fushën e mbrojtjes së të drejtës për informim

Përveç përgjegjësi të parashikuara në nenin 31, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ushtron edhe kompetencat e mëposhtme në fushën e së drejtës së informimit:

a) shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin “Për të drejtën e informimit”;

b) shqyrton ankesat e personave në lidhje me funksionimin e programeve të transparencës në autoritetet publike;

c) kryen hetimet e nevojshme administrative gjatë ushtrimit të kompetencave të tij;

ç) njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas ligjit për të drejtën e informimit apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacionet e klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këto raste, ai

është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e “sekretit shtetëror”, sipas legjislacionit në fuqi;

d) vendos sanksione administrative sipas parashikimeve të ligjit për të drejtën e informimit;

dh) nxit parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit;

e) monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit;

ë) kryen sondazhe në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit;

f) bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës;

g) me kërkesë të gjykatës që shqyrton çështjen, parashtron mendim me shkrim për çfarëdo çështjeje që lidhet me të drejtën e informimit.”.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.9.2014

KRYETARI
Ilir Meta

LIGJ

Nr. 122/2014

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 1, DATË
17.9.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME
DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 185/2013
“PËR BUXHETIN E VITIT 2014””**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 17.9.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014””.



Miratuar në datën 25.9.2014

Shpallur me dekretin nr. 8738, datë 14.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 123/2014

PËR URDHRIN E MJEKËVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ligji ka si qëllim përcaktimin e rregullave të organizimit dhe të veprimtarisë së Urdhrit të Mjekëve dhe marrëdhëniet juridike të profesionistëve mjekësorë.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjithë mjekët që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë në sistemin publik apo privat.

Neni 3

Statusi

Urdhri i Mjekëve është ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkët të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut.

KREU II
MISIONI DHE BUXHETI

Neni 4

Misioni

1. Misioni i Urdhrit të Mjekëve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesioneve në fushën e mjekësisë dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i profesionit të mjekut.

2. Për të përmbushur misionin e tij, Urdhri i Mjekëve ushtron këto kompetenca:

a) jep dhe heq licencën individuale të ushtrimit të profesionit;

b) vendos standarde etike dhe deontologjike, të detyrueshme për çdo mjek dhe monitoron zbatimin e tyre gjatë ushtrimit të profesionit;

c) rivlerëson periodikisht kompetencën dhe performancën profesionale të anëtarit të Urdhrit përballë standardeve të vendosura;

ç) nxit arritjen e standardeve të larta në edukimin dhe formimin profesional dhe etik të anëtarëve të Urdhrit;

d) bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, institucione të tjera shkencore dhe arsimore për të siguruar standarde të larta në Edukimin e Vazhdueshëm Mjekësor, kualifikimet dhe specializimet pasuniversitare të Urdhrit;

dh) mban Regjistrin Themeltar të Urdhrit dhe menaxhon sistemin e administrimit dhe përditësimit të tij;

e) mbron të drejtat e anëtarëve të Urdhrit, integritetin moral dhe profesional të tyre e të profesionit mjekësor.

Neni 5

Kriteret e anëtarësisë

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e mjekut, në sistemin e kujdesit shëndetësor publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Mjekëve dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit, të lëshuar nga ky organizëm.

2. Janë anëtarë të Urdhrit të Mjekëve të gjithë mjekët që ushtrojnë profesionin e mjekut/mjekut specialist në Republikën e Shqipërisë dhe që përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë diplomën e mjekut, mjekët specialistë edhe diplomën e specialitetit, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë brenda apo jashtë shtetit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;

c) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, në momentin e kërkesës për anëtarësim;



ç) të njohin dhe të zotohen me shkrim se do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutit, Betimin e Mjekut dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

3. Çdo mjek, shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri, apo i atashuar në një institucion shëndetësor ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit, duhet të ketë edhe këto dokumente:

a) lejen e qëndrimit dhe të punës në Republikën e Shqipërisë;

b) certifikatën e mirësjelljes (Good Standing Certificate) nga Urdhri/dhoma apo shoqata e mjekëve të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka marrë masa ndëshkimore;

c) njësimin (konvalidimin) e diplomës dhe certifikatave të specializimeve të kryera prej tij/saj;

ç) një rekomandim nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Mjekëve;

d) dëshmi të njohjes së gjuhës shqipe, të vërtetuar nga një autoritet i licencuar nga shteti. Mjeku jorezident detyrimisht punon me përkthyes.

Neni 6

Të drejtat e anëtarit të Urdhrit të Mjekëve

Anëtari i Urdhrit të Mjekëve ka të drejtë:

1. Të ushtrojë profesionin në profilin e vet;

2. Të ankohet në organet e Urdhrit kur i shkelen të drejtat dhe mundësitë për ushtrim autonom, të lirë dhe të pavarur të profesionit nga cilido qoftë;

3. Të marrë pjesë në shqyrtimin nga organizmat e Urdhrit për probleme që kanë të bëjnë me personin e tij;

4. Të kërkojë krijimin e kushteve të favorshme për ushtrimin normal të profesionit, për Edukimin e Vazhdueshëm Mjekësor dhe për përparimin e karrierës.

Neni 7

Ndërprerja e anëtarësimit

1. Anëtarit të Urdhrit të Mjekëve i ndërpritet anëtarësia në këto raste:

a) kur vdes;

b) kur i hiqet licenca individuale e ushtrimit të profesionit me vendim disiplinor të formës së prerë nga organet e Urdhrit apo të gjykatës;

c) kur është duke vuajtur dënimin penal me heqje lirie;

ç) kur nuk shlyhen kuotizacionet në përputhje me afatet e vendosura nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit dhe i kalon ato mbi 1 vit pa arsye të justifikueshme.

2. Vendimi për ndërprerje të anëtarësisë i komunikohet zyrtarisht personit dhe institucionit ku ka shërbyer i ndëshkuari.

Neni 8

Detyrimet e anëtarëve të Urdhrit

Anëtari i Urdhrit të Mjekëve ka këto detyrime:

a) të ushtrojë profesionin dhe të ketë sjellje profesionale, në përshtatje me kërkesat dhe standardet e legjislacionit shqiptar në fushën e shëndetësisë, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe statutin;

b) të punojë për rritjen e standardeve profesionale dhe të cilësisë së kujdesit shëndetësor në institucionin ku punon dhe të marrë pjesë rregullisht në programet e Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor;

c) të paguajë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifat e regjistrimit, të dhënies së të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe shërbime të tjera administrative, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 9

Bashkëpunimi

1. Urdhri i Mjekëve, gjatë veprimtarisë së tij, bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet e saj vartëse, si dhe me ministrinë, institucionet qendrore, institucionet e arsimit të lartë dhe organizmat e tjerë, publikë ose jopublikë, të krijuara sipas legjislacionit në fuqi.

2. Urdhri i Mjekëve informon çdo 6 muaj ministrinë përgjegjëse për fushën e shëndetësisë lidhur me anëtarësimet, gjykimet disiplinore dhe probleme të tjera me interes të ndërsjellë. Ky informacion publikohet edhe në faqen e internetit të Urdhrit.

3. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor bashkëpunon me Urdhrit e Mjekëve gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

4. Ministria e Shëndetësisë bashkëpunon me Urdhrit e Mjekëve për hartimin e projektligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme në fushën e shëndetësisë.



Neni 10
Buxheti

1. Urdhri i Mjekëve ka buxhetin e tij, të cilin e miraton dhe e administron Këshilli Kombëtar, në përputhje me rregullat financiare në fuqi dhe me rregulloren e brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit, të miratuar nga ky këshill.

2. Burimet financiare të Urdhrit janë:

- a) kuotizacionet e anëtarëve, masa e të cilave përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar dhe janë të detyrueshme për çdo anëtar;
- b) tarifatat e vendosura për aktet dhe dokumentet e lëshuara nga Urdhri;
- c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

3. Të ardhurat e siguruara, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të këtij neni, Urdhri i përdor për të përmbushur synimet dhe objektivat e tij në përputhje me statutin dhe me këtë ligj.

KREU III
ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 11
Organet kryesore

1. Organet kryesore të Urdhrit janë:

- a) asambltetë;
- b) këshillat;
- c) presidentët;
- ç) komisionet e gjykimit disiplinor profesional.

2. Zgjedhjet në organet e sipërpërmendura duhet të sigurojnë përfaqësim në masën 30 për qind për çdo gjini, në përputhje me ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri".

Neni 12
Asambltetë

1. Asambleja Kombëtare është organi më i lartë drejtues i Urdhrit dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e këshillave rajonale.

2. Mbledhja e Asamblesë Kombëtare thirret nga:

- a) Presidenti i Këshillit Kombëtar;
- b) kur kërkohet nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të asambltesë.

3. Asambleja rajonale zgjedh këshillin rajonal.

4. Përbërja e anëtarëve të asambltesë rajonale dhe procedurat e zgjedhjes së tyre përcaktohen në Statutin e Urdhrit të Mjekëve.

Neni 13
Këshilli Kombëtar

1. Këshilli Kombëtar përbëhet nga 25 anëtarë, ndër të cilët 20 janë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Kombëtare dhe 5 të tjerët janë, përkatësisht, Presidenti i Urdhrit të Mjekëve, zëvendësi i tij, një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, një përfaqësues nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, një përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë, të caktuar nga Presidenti i Urdhrit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në statut.

2. Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

- a) miraton strukturën e vet organizative dhe të këshillave rajonale;
 - b) cakton kuotizacionin dhe tarifatat;
 - c) zgjedh Presidentin e Urdhrit të Mjekëve dhe zëvendësin e tij;
 - ç) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar, duke përcaktuar fondet në administrimin e këshillave rajonale;
 - d) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;
 - dh) miraton statutin, rregulloret e Urdhrit si dhe Kodin Etik dhe Deontologjik të Mjekut;
 - e) ngre grupe pune *ad hoc* për kryerjen e kontroleve për ushtrimin e profesionit të mjekut.
3. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar bëhen çdo 5 vjet.
4. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar dhe ato për këshillat rajonale bëhen në të njëjtën kohë.

Neni 14
Këshillat rajonale

1. Këshilli rajonal përbëhet nga 5 deri në 9 anëtarë, në varësi të numrit të anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve.

2. Këshilli rajonal ka këto funksione:

- a) këshilli rajonal zgjedh presidentin dhe zëvendëspresidentin e tij;
- b) administron buxhetin dhe të gjitha pasuritë e Urdhrit në nivel qarku;
- c) cakton komisionin disiplinor në nivel qarku;
- ç) ngre grupe pune *ad hoc* për kryerjen e kontroleve për ushtrimin e profesionit të mjekut në nivel qarku.



3. Zgjedhjet për këshillin rajonal bëhen çdo 5 vjet.

Neni 15

Presidentët e Urdhrit

1. Presidentët e Urdhrit zgjidhen me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar dhe ai rajonal midis jo më pak se 2 kandidatave alternative.

2. Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin e Urdhrit të Mjekëve me shumicën e votave të gjithë anëtarëve të tij. Mandati i presidentit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm njëherë.

3. Këshillat rajonalë zgjedhin presidentët përkatës të këshillave rajonalë. Mandati i tyre është 5 vjet me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Kandidaturat për presidentë të Urdhrit të Mjekëve duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;

b) të kenë jo më pak se 15 vjet eksperiencë në profesion;

c) të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;

ç) të mos jenë marrë ndaj tyre masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;

d) të kenë prestigj dhe reputacion etiko-moral dhe profesional;

dh) të kenë kryer botime shkencore;

e) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

5. Funksioni i presidentëve të Urdhrit të Mjekëve është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.

6. Presidentët e urdhrave e përfundojnë mandatin e tyre përpara kohe në këto raste:

a) kur merret vendim nga Këshilli Kombëtar ose rajonal, me votat e jo më pak se dy të tretave të anëtarëve;

b) kur japin dorëheqjen;

c) kur dënohen me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ç) kur humbasin zotësinë e plotë për të vepruar;

d) kur bëhen të paaftë, për arsye shëndetësore, për të kryer detyrat e tyre, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor.

7. Procedura e zgjedhjes, detyrat dhe kompetencat e presidentëve të Urdhrit të Mjekëve përcaktohen në Statutin e Urdhrit.

Neni 16

Komisionet disiplinore

1. Pranë këshillave rajonalë dhe Këshillit Kombëtar funksionojnë komisionet disiplinore si organizma të gjykimit profesional. Komisioni disiplinor rajonal përbëhet nga 9 anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Rajonal. Komisioni Disiplinor Kombëtar përbëhet nga 15 anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.

2. Komisioni shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

3. Komisionet disiplinore, pranë këshillave rajonalë, ushtrojnë kompetenca disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre janë të apelueshme në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë.

4. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të komisioneve disiplinore përcaktohet në statutin dhe në rregulloren e gjykimit profesional të Urdhrit.

Neni 17

Masat disiplinore

1. Komisioni disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve e provave të administruara dhe seancës dëgjimore me anëtarin e Urdhrit, ndaj të cilit mund të merret masa disiplinore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës, të Kodit Etik dhe Deontologjik ose ka bërë gabime teknike, ai jep këto masa:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) gjobë nga 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë deri 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ç) propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore publike dhe private.

d) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Mjekëve deri në 3 vjet.

dh) përjashtim nga Urdhri i Mjekëve për një periudhë deri në 3 vjet.

2. Përveç masave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, si masë plotësuese, komisioni ka të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese, të barabarta me 20 kredite.



3. Masat disiplinore, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, mund të shlyhen në qoftë se ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore:

i) brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni;

ii) brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “ç”, “d” e “dh”, të pikës 1, të këtij neni.

4. Gjoha e vendosur sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni, derdhet në Buxhetin e Shtetit.

Neni 18
Ankimi

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisioni disiplinor i këshillit rajonal paraqiten në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve brenda 15 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.

2. Komisioni disiplinor, brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar ankimohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 19

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore

1. Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore është dokumenti themelor i profesionit mjekësor, në të cilin materializohen të gjithë parimet dhe standardet profesionale të detyrueshme për t'u njohur e zbatuar nga çdo anëtar i Urdhrit në praktikën mjekësore, si edhe nga çdo institucion shëndetësor.

2. Këshilli Kombëtar harton dhe miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 20

Përmirësimi i dokumenteve të Urdhrit

Këshilli Kombëtar i Urdhrit harton dhe përmirëson Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, statutin dhe rregulloret e tij pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 21

Transferimi

1. Jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, bëhen zgjedhjet e organeve drejtuese të Urdhrit dhe riorganizimi i tyre në përputhje me këtë ligj.

2. Jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, gjithë dokumentacioni dhe arkivi i lejeve të ushtrimit të profesionit të stomatologut, të dhëna deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, i transferohen Urdhrit të Stomatologëve.

Neni 22

Shfuqizimi

Ligji nr. 8615, datë 1.6.2000, “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.9.2014

Shpallur me dekretin nr. 8739, datë 14.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 124/2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9718, DATË 19.4.2007, “PËR URDHRIN E INFIERMIERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9718, datë 19.4.2007, “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:



Neni 1

Në nenin 6, pika 2, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) garanton që anëtarët e Urdhrit përmbushin detyrimet e programit të ricertifikimit, të vendosur nga institucioni përkatës.”.

Neni 2

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

1. Urdhri i Infermierit, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet e saj të varësisë si dhe me ministrinë, institucionet qendrore dhe organizma të tjerë publikë ose jopublikë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Urdhri i Infermierit informon çdo 6 muaj ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për anëtarësimet e infermierëve, mamive, fizioterapeftëve, teknikëve të laboratorit, teknikëve të imazherisë dhe logopedistëve, për gjykimet disiplinore dhe ecurinë e tyre në të gjitha shkallët e gjyimit profesional. Ky informacion publikohet edhe në faqen e internetit të Urdhrit.

3. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor bashkëpunon me Urdhrit të Infermierit gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

4. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë bashkëpunon me Urdhrit të Infermierit për hartimin e projektligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme në fushën e shëndetësisë.”.

Neni 3

Në nenin 9 bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) presidentët e Urdhrit.”.

2. Në fund të nenit 9 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Zgjedhjet në organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të sigurojnë përfaqësim në masën 30 për qind për çdo gjini, në përputhje me ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri.”.

Neni 4

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

Faqe | 8176

“Neni 9/1

Presidentët e Urdhrit

1. Presidentët e Urdhrit zgjidhen me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar dhe këshillat rajonale të Urdhrit ndërmjet jo më pak se 2 kandidatash alternative.

2. Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin e Urdhrit të Infermierit, me mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

3. Këshillat rajonale zgjedhin presidentët e këshillave rajonale. Mandati i tyre është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Kandidaturat për presidentë të Urdhrit të Infermierit duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;

b) të kenë jo më pak se 15 vjet përvojë në profesion;

c) të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizuese e drejtuese;

ç) të mos kenë marrë masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;

d) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale.

5. Funksioni i presidentëve të Urdhrit të Infermierit është i papajtuësëm me funksione të tjera administrative, shtetërore apo politike.”.

Neni 5

Në nenin 10, pika 1, emërtimi “Asambleja e Përgjithshme” zëvendësohet me emërtimin “Asambleja Kombëtare”.

Neni 6

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Këshilli rajonal

1. Këshilli rajonal krijohet në bazë qarku dhe përbëhet nga 5 deri 9 anëtarë në varësi të numrit të anëtarëve të Urdhrit të Infermierit, në qark.

2. Këshilli rajonal zgjedh presidentin dhe zëvendësit e tij.

3. Këshilli rajonal emëron dhe shkarkon sekretarin e tij.”.



Neni 7

Në nenin 12, pika 1 ndryshohet si më poshtë:
 “1. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit përbëhet nga jo më shumë se 25 anëtarë, si më poshtë:

- a) Presidenti i Urdhrit të Infermierit;
- b) zëvendëspresidenti;
- c) presidentët e këshillave rajonalë;
- ç) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;
- d) një përfaqësues i shkollave të larta të infermierisë;
- dh) një përfaqësues i Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor;
- e) dy përfaqësues të Shoqatës së Pacientëve;
- ë) një përfaqësues i Sindikatës së Infermierëve;
- f) pesë anëtarë të zgjedhur nga asambleja kombëtare, sipas qarqeve me numër popullsisë më të madhe.”.

Neni 8

Në nenin 16, pika 2, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:
 “c) gjobë nga 1 500 lekë deri në 100 000 lekë.”.
2. Në fund të shkronjës “dh” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
 “Gjoha e vjelë, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 16, derdhet në Buxhetin e Shtetit.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.9.2014

Shpallur me dekretin nr. 8740, datë 14.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 125/2014

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 17/2014, DATË 20.2.2014, “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8580, DATË 17.2.2000, “PËR PARTITË POLITIKE”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 17/2014, datë 20.2.2014, “Për një shtesë në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar”, pas nenit 1 shtohet neni 1/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 1/1

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji, për vitin buxhetor 2014, shtrihen vetëm për periudhën nga hyrja në fuqi e tij deri në fund të vitit.

Përjashtimisht për vitin 2014, Ministria e Financave, në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike, në formën e ndihmës financiare vjetore, në përputhje me këtë ligj.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.9.2014

Shpallur me dekretin nr. 8741, datë 14.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8730, datë 3.10.2014

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:

Ilirian Ali Aliaj



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8737, datë 13.10.2014

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Albulena Shaban Istrefi (Binakaj)
2. Bujar Qazim Hasi
3. Ömer Abdurrahman Orhanalp
4. Nejla Müslüm Orhanalp (Çadirci)
5. Cansu Ömer Orhanalp
6. Vesel Xhelil Duraj
7. Yakup Metin Remzi Karahan
8. Tetjana (Tetyana) Mikola Hoxha (Halajko)
9. Hasan Nasuh Çelik
10. Alev Ahmet Pekin (Tekiş)
11. Alla Aleksandr Simaçeva (Simacheva)
12. Avni Rexhep Podrimaj
13. Kamuran Ibrahim Aydin

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

UDHËZIM

Nr. 35, datë 30.9.2014

**PËR PROCEDURAT LËVIZJES
PARALELE, TË EMËRIMIT DHE TË
LARGIMIT NGA PUNA TË MËSUESIT
NË INSTITUCIONIN PUBLIK TË
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe neneve 26, 54 dhe 60 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:**KREU 1**

**EMËRIMI I MËSUESIT NË
INSTITUCIONIT PUBLIK
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

I. Shpallja e vendit të lirë dhe lëvizja paralele për mësues në institucionin publik të arsimit parauniversitar

Drejtori i institucionit publik të arsimit parauniversitar, brenda 2 ditëve nga dita kur vendi i një mësuesi lirohet, shpall vendin e lirë të punës. Shpallja i dërgohet fillimisht DAR/ZA-së nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni arsimor për njoftimin e kërkuësve për lëvizje paralele.

Afati i njoftimit dhe dorëzimit të dokumentacionit për lëvizje paralele, nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë.

Vendet e shpallura të lira në fillim u ofrohen mësuesve të të njëjtit profil dhe nivel, brenda së njëjtës njësi arsimore vendore (DAR).

Kërkesat për lëvizje paralele dhe dokumentacioni përkatës i paraqiten drejtorisë së institucionit publik të arsimit parauniversitar, ku është vendi i lirë i punës.

Drejtorja e institucionit publik të arsimit parauniversitar, mbi bazën e kërkesave të paraqitura, ngre komisionin sipas pikës 2/III të këtij udhëzimi, për shqyrtimin e kërkesave për lëvizje paralele të mësuesve nga një institucion arsimor në një tjetër, për të njëjtin profil dhe nivel dhe brenda së njëjtës njësi arsimore vendore (DAR).

Komisioni shqyrton kërkesat për lëvizje paralele brenda 3 ditëve.



Kriteret e shqyrtimit të kërkesave në rast se janë më shumë se një, për të njëjtin institucion arsimor, të bazohen në:

Kriteri	Përvojë pune dhe kualifikime	Shkallë kualifikimi	Aftësi të veçanta, gjuhë të huaja, botime etj.	Intervista me gojë
Pikët	Deri 10 pikë	Deri 12 pikë	Deri 8 pikë	Deri 10 pikë

Mbi bazën e pikëve të grumbulluara, komisioni liston kandidatët dhe ia paraqet drejtorit të institucionit arsimor, për emërimin e mësuesit me më shumë pikë të grumbulluara.

Në rast se nuk ka kërkesa për lëvizje paralele, për institucionin arsimor ku është shpallur vendi i lirë i punës, për profilin/nivelin përkatës brenda 2 ditëve nga përfundimi i afatit 10-ditor për paraqitjen e dokumentacionit, drejtoria e institucionit arsimor parauniversitar, në bashkëpunim me DAR/ZA, shpallin vendin e lirë për konkurrim për kandidatë jashtë sistemit arsimor, në një mjedis publik të shkollës përkatëse ambientet e DAR/ZA dhe në faqet e internetit.

Afati i njoftimit dhe dorëzimit të dokumentacionit për konkurrim nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë.

Komisioni shqyrton kërkesat për konkurrim brenda 3 ditëve.

II. Dokumentacioni i aplikimit për mësues dhe afati i dorëzimit

1. Kandidati për mësues duhet të përmbushë kushtet e nenit 57 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 dhe të plotësojë kriteret që përcaktohen në kontratën kolektive të punës të nivelit të parë.

2. Paketa e aplikimit për mësues përmban:

a) CV dhe kopje të dëshmimeve apo dokumente që vërtetojnë pohimet në CV (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi).

b) Tabelën e të dhënave për aplikant (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi).

c) Raportin mjeko-ligjor.

d) Dëshminë e masave disiplinore në fuqi në ngarkim të tij (Nëse nuk ka, e deklaron me shkrim që nuk ka).

e) Dëshminë e penaltetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit.

Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në drejtorinë e institucionit arsimor, me procesverbal dorëzimi.

Dorëzimi i dokumentacionit kryhet jo më vonë se dhjetë ditë pas shpalljes së vendit të lirë.

III. Ngritja dhe përbërja e komisionit të vlerësimit

1. Komisioni i vlerësimit të kandidatëve për pozicionin e mësuesit në institucionin arsimor ngrihet nga drejtori i institucionit arsimor.

2. Komisioni i vlerësimit (komisioni) përbëhet nga:

a) një përfaqësues nga njësia arsimore vendore;

b) kryetari i bordit të institucionit;

c) kryetari i këshillit të prindërve të institucionit;

d) dy mësues që zgjidhen nga këshilli i mësuesve në atë institucion. Një nga dy mësuesit me përvojën më të gjatë në atë institucion drejton komisionin e vlerësimit.

3. Titullari i njësisë arsimore vendore cakton një përfaqësues në komision, duke pasur parasysh profilin e mësuesit që kërkohet.

4. Anëtarët e komisionit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikantin në kuptim të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, gjë të cilën e deklarojnë me shkrim.

IV. Detyrat dhe puna e komisionit të vlerësimit

1. Komisioni mbledhet në mjediset e institucionit arsimor, në datën e caktuar nga kryetari i komisionit brenda afatit të caktuar në pikën I të këtij udhëzimi.

2. Komisioni kryen këto detyra:

a) Shqyrton kërkesat për lëvizje paralele, sipas përcaktimeve të pikës I të këtij udhëzimi.

b) Shqyrton kërkesat për konkurrim nga jashtë sistemit, sipas shtojcave nr. 1 dhe nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi, dokumentacionin e paraqitur nga të gjithë kandidatët dhe liston aplikantët me dokumentacionin e plotë, të cilët do të vlerësohen nga komisioni.



Aplikantët që nuk pranohen, njoftohen me shpallje në mjediset e institucionit arsimor. Aplikantët e skualifikuar kanë të drejtën e ankimit brenda ditës pranë drejtuesit të DAR/ZA sipas juridiksionit të institucionit arsimor parauniversitar, i cili shqyrton ankimin, sipas këtij udhëzimi.

c) Vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

d) Interviston secilin aplikant për metodat e tij të punës dhe e vlerëson me pikët nga 1 në 10.

3. Komisioni mbledh pikët e secilit aplikant dhe liston aplikantët sipas pikëve të grumbulluara.

4. Brenda së njëjtës ditë, komisioni shpall, në një vend publik në institucion, listën e kandidatëve me pikët e secilit aplikant (shtojca 4). Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit brenda 2 ditëve pune, nga dita e shpalljes së listës përfundimtare.

5. Kryetari i komisionit i dorëzon drejtorit të institucionit arsimor dosjet e aplikimit dhe listën e vlerësimeve me pikët e të gjithë kandidatëve.

6. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit pranë drejtuesit të DAR/ZA, i cili shqyrton ankimet e paraqitura sipas pikës 2 brenda ditës dhe sipas pikës 4 brenda 2 ditëve pune, duke urdhëruar lënien në fuqi ose shfuqizimin e akteve të komisionit dhe vendos vetë sipas objektit të ankimit dhe Kodit të Procedurave Administrative.

V. Procedura e emërimit të mësuesit nga drejtori i institucionit arsimor

1. Drejtori i institucionit arsimor emëron kandidatin me më shumë pikë të listuar në listën e komisionit apo të drejtuesit të DAR/ZA. Në rast se ka dy kandidatë me të njëjtët pikë, drejtori hedh short në prani të kandidatëve dhe emëron kandidatin fitues.

2. Brenda dy ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit nga komisioni/drejtuksi i DAR/ZA-së, drejtori shpall në një vend publik të institucionit arsimor mësuesin e emëruar prej tij.

3. Vendimi për emërim i dërgohet për njoftim titullarit të njësisë arsimore vendore, dhe mësuesit të sapoemëruar.

KREU 2

LARGIMI I MËSUESIT NGA PUNA

I. Mbarimi i marrëdhënieve të punës

Mbarimi i marrëdhënies së punës së mësuesit të institucionit publik të arsimit parauniversitar, bëhet:

- a) kur jep dorëheqjen;
- b) kur mbush moshën e pensionit;
- c) kur bëhet i paaftë për kryerjen e detyrave për shkaqe fizike ose mendore;
- d) kur dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës;
- e) kur merret masa disiplinore e largimit nga puna.

II. Rastet e largimit të mësuesit nga puna

1. Drejtori i institucionit arsimor largon mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar në rastet e shkeljeve flagrante ose kur ka një vendim të formës së prerë në ngarkim të tij nga organet kompetente për një ose më shumë nga rastet e mëposhtme:

- a) Ka falsifikuar dokumente zyrtare;
- b) Ka nxitur vartësit e tij të falsifikojnë dokumente zyrtare;
- c) Ka ushtruar dhunë fizike ndaj nxënësve ose punonjësve të institucionit;
- ç) Ka ngacmuar seksualisht nxënës ose punonjës të institucionit;
- d) Ka përvetësuar fonde financiare ose materiale të institucionit;
- e) Ka organizuar kurse me pagesë me nxënësit që mëson ose me nxënësit e shkollës së tij.
- f) Ka organizuar kurse me pagesë me nxënës jashtë shkollës së tij, kur nuk është i licencuar për të ushtruar këtë veprimtari private;
- dh) Ka marrë rryshfet;
- g) Ka bërë deklaratë të rreme në procesin e aplikimit.

2. Drejtori i institucionit arsimor largon mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar për mosarritje të nxënësve të tij sipas pikës 2/c të nenit 60 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

3. Drejtori i institucionit arsimor largon nga puna mësuesin, kur mësuesi kryen shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, kontratës kolektive ose individuale të punës dhe të legjislacionit në fuqi.

4. Ndërprerja e marrëdhënieve të punës kryhet nga drejtori i institucionit arsimor parauniversitar, sipas përcaktimeve të Kodit të Punës dhe janë objekt ankimi në rrugë administrative.



KREU 3
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të mësuesit janë objekt i inspektimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

2. Udhëzimi nr. 56, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar” dhe udhëzimi nr. 22, datë 29.7.2010 i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për emërimin e personelit mësimor dhe drejtues në arsimin parauniversitar”, shfuqizohen.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, njësitë arsimore vendore dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

SHTOJCA 1
CURRICULUM VITAE

- I. EMRI MBIEMRI
- II. DATËLINDJA
- III. TELEFONI
- IV. ARSIMI
- V. KUALIFIKIMI
- VI. CERTIFIKATA
- VII. PUNËSIMI
- VIII. BOTIMET
 - a) LIBRA
 - b) SHKRIME
 - c) REFERIME
- IX. PROJEKTE
- X. PROVIMET KOMBËTARE

Dëshmoj se i kam kuptuar udhëzimet për plotësimin e shtojcës 1 dhe pasojat nga plotësimi i pasaktë i saj.

Nënshkrimi

Data

UDHËZIME
PLOTËSIMI I CURRICULUM VITAE

ARSIMI

Diploma (diplomat) e shkollës së lartë.

Licenca pas kalimit me sukses të Provimit të Shtetit (nëse i takon marrja e licencës)

KUALIFIKIMI

Kategoria e kualifikimit si mësues dhe vlerësimi i kualifikimit (nëse ka pasur vlerësim)

NOTA MESATARE

Nota mesatare në shkollën e lartë (e rrumbullakosur në numër të plotë)

CERTIFIKATA PËR DREJTIMIN E ARSIMIT

CERTIFIKATA PËR ASPEKTE TË TJERA ARSIMORE

Shënim

Certifikatat mund të jenë marrë brenda ose jashtë vendit.

Ndër certifikatat e marra brenda vendit, vendosen vetëm ato që dëshmojnë marrjen e krediteve.

PUNËSIMI

Renditen, njëra pas tjetrës, të gjitha punësimet, duke filluar nga e tanishmja deri te punësimi i parë.

Për çdo punësim shkruhet:

- Viti i fillimit dhe i mbarimit të tij;
- Titulli i vendit të punës (mësues i matematikës në arsimin bazë, mësues i fillores, nëndrejtor, drejtor shkolle, inspektor etj.);
- Adresa e vendit të punës (shkolla e mesme “Kristoforidhi”, Elbasan; Inspektor, DAR Elbasan.)

P.sh.:

1997-2000 Inspektor, DAR Elbasan

1990-1997 Drejtor, shkolla e arsimit bazë “Naim Frashri”, Elbasan

1990 – 1997 Mësues, shkolla e mesme “Kristoforidhi”, Elbasan

Nëndrejtor (Vitet)¹

BOTIMET

Përmenden vetëm botime të cilat kanë të bëjnë me arsimin duke filluar nga 1 janar 1992.

Për çdo botim shkruhet emri e mbiemri i bashkautorëve (nëse ka), titulli i botimit, institucioni botues dhe viti i botimit.

¹ Shënoni numrin e viteve, duke filluar nga zero.



Botimet ndahen në libra dhe shkrime.

LIBRA

Librat ndahen në:

- Tekste shkollore,
- Tekste për mësuesit,
- Libra për drejtimin e shkollës,
- Libra për çështje të tjera arsimore.

Secili prej katër llojeve të mësipërme të librave renditet me numrat 1, 2, ...

P.sh.:

Tekste shkollore

Nuk ka

Tekste për mësuesit

1) Me Agim Korabin; Teksti i nxënësit “Fizika 7”, Shtëpia botuese “Egla”, 1997

Libra për drejtimin e shkollës

Nuk ka.

Libra për çështje të tjera arsimore

1) “Strategjitë e mësimdhënies dhe të të nxënit”, Shtëpia Botuese “Egla”, 2004

2) “Braktisja e shkollës në qarkun e Shkodrës, Shtëpia botuese “7 Marsi”, 2010

SHKRIME

Shkrimet ndahen në:

- Për drejtimin e shkollës,
- Për çështje të tjera arsimore.

Secili prej dy llojeve të mësipërme renditet me numrat 1, 2, ...

P.sh.:

Drejtimi i shkollës

1. “Drejtori i shkollës - menaxheri i saj”, Gazeta “Mësuesi”, 2007

2. “Reforma e drejtimit të shkollës te ne dhe në vendet fqinje”, Gazeta “Shekulli”, 2011

Çështje të tjera arsimore

Nuk ka.

KUMTESA

Përfshihen kumtesa në konferenca, simpoziume etj., të mbajtura brenda ose jashtë vendit.

Për çdo referim tregohet emri e mbiemri i bashkautorëve (nëse ka), titulli i kumtesës, emri i konferencës ose simpoziumit, vendi dhe viti i mbajtjes.

Secila prej tyre renditet me numrat 1, 2, ...

P.sh.:

Kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin

1. “Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në veprimtari jashtëshkollore”, Konferenca “Fëmijët me aftësi të kufizuara”, Bukuresht, botuar në revistën “*Education for all*”, 2003

Kumtesa në takime kombëtare për arsimin

1. Me Etleva Martën, Blerim Tiranën, Altin Kotten, “Reforma e sistemit të trajnimit të mësuesve në vendet në tranzicion”, Konferenca “Trajnimi i mësuesve”, Tiranë, 2006

PROJEKTE

Këtu përfshihen pjesëmarrjet në projekte që kanë të bëjnë vetëm me drejtimin e institucionit arsimor (kopsht, shkollë).

Për secilin projekt përmendet titulli, organizmi që ka mbështetur realizmin e projektit, viti (vitet) kur është zhvilluar projekt, roli në projekt.

Secili prej tyre renditet me numrat 1, 2, ...

P.sh.:

1. Projekti “Studimi mbi braktisjen e shkollës nëntëvjeçare”; UNICEF, 2004-2006. Kam zhvilluar pyetësorë me prindërit e nxënësve braktisës.

2. Projekti “Dhuna në mjediset e shkollës”, OJF “Ruga e dritës”, 2001. Koordinator i projektit.

PROVIMET KOMBËTARE

Administrator në provimet kombëtare (matura ose lirim) (Vitet)

Hartues i testeve në provimet kombëtare (matura ose lirim) (Vitet)

Vlerësues i përgjigjeve të nxënësve në provimet kombëtare (matura ose lirim) (Vitet)

VINI RE!

- Për kategorinë e kualifikimit si mësues, diploma (diplomat) e shkollës së lartë, licencën dhe notat e shkollës së lartë paraqiten kopje të noterizuara të tyre.

- Për certifikata paraqiten kopjet e tyre.

- Për librat paraqiten kopja e ballinës.

- Për shkrimet paraqiten kopje të faqes së parë.

- Për kumtesat paraqiten kopja e faqes së parë.

- Për provimet kombëtare paraqiten dëshmi të firmosura nga DAR ose ZA përkatëse



SHTOJCA 2: TABELA E TË DHËNAVE PËR APLIKANTIN

Emri e mbiemri _____

Aplikanti shënon brenda kllapave, krahas zërit përkatës:

- Numrin, kur kërkohet numri.
- “PO” ose “JO”, kur kërkohet përgjigje e tillë.

I	CERTIFIKATA
1	Certifikata për drejtimin e arsimit (numri i tyre)
2	Certifikata për aspekte të tjera arsimore (numri i tyre)
3	Kredite si drejtor (numri)
4	Kredite si mësues (numri)
II	LIBRA
1	Autor në tekstet shkollore (numri i tyre)
2	Autor në tekstet për mësuesit (numri i tyre)
3	Autor libri për drejtimin e shkollës (numri i tyre)
4	Autor libri për çështje të tjera arsimore (numri i tyre)
III	SHKRIME
1	Shkrime për drejtimin e shkollës (numri i tyre)
2	Shkrime për çështje të tjera arsimore (numri i tyre)
IV	KUMTESA
1	Kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin (numri i tyre)
2	Kumtesa në takime kombëtare për arsimin (numri i tyre)
V	GJUHA E HUAJ E MBROJTUR
1	Gjuha angleze ()
2	Gjuhë e huaj tjetër e vendeve të BE-s (numri i gjuhëve)
VI	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TË MBROJTURA OSE ME KREDITE)
1	Microsoft Word ()
2	Përdorimi i internetit ()
3	Excel ()
4	Power point ()
VII	NOTAT
	Nota mesatare në shkollën lartë, e rumbullakosur në numër të plotë ()
VIII	PROVIMET KOMBËTARE (lirimi ose matura)
1	Administrator në provimet kombëtare (numri i herëve)
2	Hartues i testeve në provimet kombëtare (numri i herëve)
3	Vlerësues i përgjigjeve të nxënësve në provimet kombëtare (numri i herëve)
IX	PROJEKTE (numri i tyre)
X	ROLE NË DREJTIM
	Nëndrejtor (Vitet)

Dëshmoj se i kam kuptuar udhëzimet për plotësimin e shtojcës 2 dhe pasojat nga plotësimi i pasaktë i saj.

Nënshkrimi, data



SHTOJCA 3 REKOMANDIMET

Një rekomandim zë jo më shumë se gjysmë faqe. Lëshohet nga mësues, drejtor i institucionit arsimor ose titullar, me kusht që aplikanti të ketë punuar vitet e fundit shkollorë me rekomanduesin. Nuk lejohet që të dy rekomanduesit të jenë mësues.

Rekomandimi përshkruan tri aspekte të veprimtarisë profesionale të aplikantit, duke përdorur fjalët “Mjaftueshëm”, “Mirë” ose “Shumë mirë”. Këto aspekte janë:

- Zbatimi i ligjshmërisë.
- Etika dhe sjellja.
- Arritjet profesionale.

Rekomanduesi mund të shkruajë ndonjë ngjarje të spikatur në karrierën e aplikantit.

SHTOJCA 4

UDHËZIM PËR KOMISIONIN E VLERËSIMIT

Pranimi ose mospranimi i një aplikimi

Komisioni nuk pranon aplikimet në të cilat mungon dokumentacioni i përcaktuar si i detyrueshëm në udhëzim.

Pikët e intervistës

Mblidhen pikët e secilit anëtar të komisionit. Shuma pjesëtohet me numrin e anëtarëve të komisionit dhe rezultati rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

Pikët e një aplikanti

Për të plotësuar pikët e një aplikanti, komisioni harton tabelën si më poshtë dhe vlerëson:

Kriteri	Përvojë pune dhe kualifikime	Shkallë kualifikimi	Aftësi të veçanta, gjuhë të huaja, botime	Intervista me gojë
Pikët	Deri 10 pikë	Deri 12 pikë	Deri 8 pikë	Deri 10 pikë

Shpallet tabela e pikëve totale për të gjithë aplikantët.

P.sh.:

Emri e mbiemri i aplikantit	Pikët totale
A	
B	
C	

Nënshkrimet e anëtarëve të komisionit

KËRKESË

Nr. 4879/3, datë 10.10.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Përdorura në qytetin e Korçës”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Ujësjiellës Kanalizime Korçë(UKKO) sh.a. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që Faqe | 8184

zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë ministrisë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit “arë”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Ujësjiellës Kanalizime Korçë(UKKO) sh.a., (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe



marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 25 805 329 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e pesë mijë e treqind e njëzet e nëntë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI SHPRONËSIMEVE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË
UJËRAVE TË PËRDORURA KORÇË

Nr.	PRONARI			Zona kadast.	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe arë (m ²)	Çmimi për njësi (lekë/m ²)	Vlera (në lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri						
1	Sotiraq	Vani	Bicolli	8561	24/46	9000	416.6	3,749,400	Konfirmim ZRPP
2	Bujar	Meleq	Feçanji	8561	24/45	3000	416.6	1,249,800	Pa certif. pronësie, certif. e pron. nuk është lëshuar pasi nuk ka ardhur konfirmim nga KVVTP
3	Hasan	Sali	Ramollari	8561	24/44	3000	416.6	1,249,800	Konfirmim ZRPP
4	Irfete	Zeqir	Unaza	8561	24/43	4000	416.6	1,666,400	Konfirmim ZRPP
5	Marjana	Postol	Gjinko	8561	24/42	1000	416.6	416,600	Konfirmim ZRPP
6	Roland	Dhori	Mizaku	8561	24/41	4500	416.6	1,874,700	Konfirmim ZRPP
7	Stavri	Spiro	Dede	8561	24/40	5460	416.6	2,274,636	Konfirmim ZRPP
8	Enver	Muharem	Take	8561	24/39	6000	416.6	2,499,600	Konfirmim ZRPP
9	Sybi	Muharem	Take	8561	24/38	5764.0	416.6	2,401,282	Konfirmim ZRPP
10	Venetike	Sybi	Qeraxhi	8561	24/37	5.7	416.6	2,375	Konfirmim ZRPP
11	Pellumb	Hamit	Nako	8561	24/36	624	416.6	259,958	Konfirmim ZRPP
12	Ramadan	Muharem	Lipo	8561	24/35	1750	416.6	729,050	Konfirmim ZRPP
13	Fredi	Muhamet	Stringa	8561	24/34	3055	416.6	1,272,713	Konfirmim ZRPP
14	Sofia	Niko	Hoxhalli	8561	24/33	2066	416.6	860,696	Konfirmim ZRPP
15	Valter	Refat	Myrteza	8561	24/32	11406	416.6	4,751,740	Konfirmim ZRPP
16	Sabrie	Nexhip	Dishnica	8561	24/31	1312.0	416.6	546,579	Konfirmim ZRPP
Vlerat totale e shpronësimit								25,805,329	

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr.1331 (13-2014-5483), datë 22.9.2014, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Bardhul Musaj, lindur më 4.10.1940, në Kishtë, Gramsh, i regjistruar aktualisht në zyrën e gjendjes civile nr.6, Tiranë, duke përcaktuar si ditë të vdekjes së tij datën 13.4.2001.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 1336, datë 19.9.2014, ka vendosur shpalljen të vdekur të shtetasit Roland Gjyli, i biri i Albertit dhe Myneveres, i datëlindjes 8.9.1978, duke përcaktuar si datë të vdekjes, datën 30.4.1998.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja “Kristalina”
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 28 lekë